



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
MINISTRI**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Nr. 1, Email: info@zhvillimiurban.gov.al

UDHËZIM

Nr. 2 datë 14/03/ 2017

PËR

**NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 16.03.2017 "PËR MËNYRËN DHE
PROCEDURAT E ZBATIMIT TË PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 5 dhe 8 të Ligjit nr. 107/2014, datë 30.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, nenit 14 të Ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar, nenit 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 410, datë 27.6.2012 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 1, datë 16.03.2017, "Për mënyrën dhe procedurat e zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore" mbas paragrafit "DH", bëhen këto shtesa :

1. Shtohet paragrafi " E" me përmbajtje si më poshtë:

E. Fillimi i zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore

16.Plani i Përgjithshëm Vendor hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga data e botimit në Regjistrin e Integruar të Planifikimit të vendimit të KKT-së që e miraton atë, së bashku me dokumentacionin shoqërues, sipas nenit 56, paragrafi 2, i ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar.

16. Plani i Përgjithshëm Vendor hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga data e botimit në Regjistrin e Integruar të Planifikimit të vendimit të KKT-së që e miraton atë, së bashku me dokumentacionin shoqërues, sipas nenit 56, paragrafi 2, i ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar.

17. Deri në momentin e hyrjes në fuqi të Planit të Përgjithshëm Vendor, sipas pikës 16 më sipër, gjejnë zbatim aktet ligjore që rregullojnë zhvillimin e territorit në mungesë të planeve vendore, përfshirë VKM nr. 283, datë 1.4.2015, Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", i ndryshuar dhe Vendimi nr. 01, datë 30.07.2015, "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi, deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore".

Ngarkohen bashkitë dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit me zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EGLANTINA GJERMENI

Nr 2345 pvd